VENDIM
Nr. 157, datë 2.3.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 769, DATË 15.7.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
"PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE (AMSHC)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 10093, datë 9.3.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 769, datë 15.7.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Lidhja 1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në lidhjen 2 "Organika e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile" bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas ndarjes IV shtohet ndarja V, me këtë përmbajtje:

"V. Njësia për Sekretariatin e KKSHC-së

Specialist - marrëdhëniet me jashtë të KKSHC-së	IV-a 1;
Specialist - Draftimi dhe përgatitja e materialeve	IV-a 1;
Specialist - arkivim dhe komunikim	IV-a 1.".

b) Në fund të lidhjes fjalët "Punonjës gjithsej 13" bëhen "Punonjës gjithsej 16".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr.1

Struktura Organizative e AMShC –së